

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



INFORMOHU
PËR NDIHMËN
JURIDIKE FALAS

NDIHMJA JURIDIKE FALAS

ÇFARË ËSHTË NDIHMA JURIDIKE FALAS?

Shërbim për qytetarët me të ardhura të ulëta, personat e përjashtuar në aspekt social, kategoritë e qytetarëve dhe personave të marginalizuar, dhe ato të cilët për çfarëdo arsye janë gjendur në pozitë të vështirë materiale dhe për këtë arsye nuk janë në gjendje të paguajnë avokat që të mbrojnë të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me të drejtën ndërkombëtare dhe nacionale të shtetit. E drejta në ndihmë juridike falas buron nga e drejta e barazisë të të gjithë qytetarëve para Kushtetutës dhe ligjeve në realizimin dhe të gëzuarit e lirive dhe të drejtave.

Ndihma juridike falas është përkufizuar me Ligjin për ndihmë juridike falas, qëllimi i të cilit është që të mundësojë dhe avancojë të drejtën e qasjes në drejtësi dhe mbrojtje të drejtë gjyqësore. Me këtë ligj janë të përfshirë llojet e ndihmë juridike deri te të cilat mund të vijë kërkuesi. Ligji njih:

- ✓ **ndihmë juridike primare (parësore)** – forma e parë e informimit juridik, njohja me të drejtat dhe detyrimet, këshillimi, udhëzimi dhe përmbajtja e formularëve të thjeshtë në procedurën administrative, parashtresat deri te Avokati i popullit dhe Komi-

soni për mbrojtje nga diskriminimi dhe përmbajtja e kërkesave për mbrojtje të lirive dhe të drejtave para Gjykatët kushtetuese. Ndihma juridike primare përfshin edhe këshillimin juridik për shfrytëzimin e të drejtës të ndihmës juridike sekondare (dytësore) dhe ndihma juridike në përpilimin e kërkesës për ndihmë juridike sekondare.

- ✓ **ndihmë juridike sekondare** – sigurohet për kërkuesit të cilëve u nevojitet zhvillimi i procedurave gjyqësore, administrative dhe administrative-gjyqësore, dhe përfshin:
 - Ndihmën juridike profesionale nga avokati për përfaqësimin dhe përpilimin e shkresave në procedurat e përmendura dhe procedurat para Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, Fondit për sigurimin shëndetësor dhe personat të cilët ushtrojnë autorizime publike (noterët dhe përmbartuesit nën kushte të veçanta);
 - Lirimi i shfrytëzuesit nga shpenzimet e ekspertizës, dhe
 - Lirimi i shfrytëzuesit nga taksat administrative.

KUJT I TAKON NDIHMË JURIDIKE FALAS?

Ndihma juridike falas u takon personave të cilët duke marrë parasysh pozitën e tyre materiale, nuk do të mund t'i realizonin të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe ligj, pa rrezikuar mbajtjen personale mbajtjen e anëtarëve të familjes të tyre me të cilët jetojnë në ekonominë familjare të përbashkët.

Personat të cilët mund të marrin ndihmë juridike falas nëse bëjnë pjesë në këtë kategori, janë të ndarë në disa grupe:

A. shtetasit e Republikës të Maqedonisë me vendbanim të përherëshëm në Republikën e Maqedonisë, dhe atë:

- personat që janë shfrytëzues të ndihmës sociale,
- shfrytëzues të të drejtës të shtesës familjare, të cilët nuk realizojnë të ardhura tjera në bazë të përfitimit apo të ardhura nga patundshmëritë,
- shfrytëzues të pensionit më të ulët të cilët jetojnë në bashkësinë familjare me dy apo më shumë persona të mbajtur prej tij,



- familje apo prind të vetëm me një apo më shumë persona të mitur të cilët realizojnë të drejtën e shtesës fëmijërore,
- fëmijë në rrezik dhe
- fëmijë për të cilin ekzistojnë bazat e dyshimit se ka kryer vepër e cila me ligj është paraparë si vepër penale apo kundërvajtje.

B. kërkuesi i të drejtës të azilit, personat e zhvendosur brenda vendit, si dhe personi i zhvendosur apo i ndjekur o cili në territorin e Republikës të Maqedonisë ka vendqëndrim,

C. shtetas i huaj, i cili në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare, pavarësisht nëse në territorin e Republikës të Maqedonisë ka vendqëndrim apo vendbanim, realizon të drejtën e tij për të cilën është kompetent organi shtetëror i Republikës të Maqedonisë,

Ç. person pa shtetësi, që ligjërisht banon në Republikën e Maqedonisë dhe

D. shtetas i vendit anëtarë të Bashkimit Europian nën kushte dhe mënyrë të përcaktuar me ligj.

A U TAKON FËMIJËVE NDIHMË JURIDIKE FALAS?

Fëmijë është çdo person deri në moshën madhore, respektivisht deri në arritjen e moshë 18 vjeçare. Nëse fëmija duhet të realizojë ndonjë të drejtë apo i nevojitet mbrojtje gjyqësore, dhe i përmbush kushtet e shënuara në ligjin për ndihmë juridike falas, ka të drejtë në këtë ndihmë.

Njëri apo të dy prindërit apo kujdestari mund të kërkojnë ndihmë juridike falas për fëmijën.

KUR KONSIDEROHET SE ËSHTË RREZIKUAR MBAJTJA?

Konsiderohet se është rrezikuar mbajtja e personit që kërkon ndihmë juridike falas dhe mbajtja e anëtarëve të familjes të tij me të cilët jeton në ekonominë familjare të përbashkët nëse të ardhurat nga të gjithë bazat e atij personi dhe anëtarëve të familjes të tij nuk e tejkalojnë vlerën prej 50% nga rroga mesatare mujore e paguar në Republikën e Maqedonisë për muajin paraprak në kohën e dorëzimit të kërkesës për ndihmë juridike falas.



A KA PËRJASHTIME NGA KËTO KUSHTE?

PËR CILAT RASTE MUND TË MARRË NDIHMË JURIDIKE SEKONDARE FALAS?

Kërkesa për ndihmë juridike falas do të miratohet paravarsisht mundësive financiare të kërkuarit, nëse i njëjti:

- ✓ Është vendosur në familje përkujdesëse, njësi banesore për jetesë të organizuar me mbështetje apo në entin për mbrojtje sociale, me vendim të QPS
- ✓ Është viktimë e dhunës në familje, që njëkohësisht ka nevojë për inicim të procedurës dhe përfaqësim në procedurën për shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje,
- ✓ Është person i cili për shkak të fatkeqësisë elementare, fuqisë madhore apo rethanave tjera të cilat janë jashtë kontrollit të tij, është në gjendje financiare që e pengon që në mënyrë të pavarur të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të tij.

Mund të kërkoet shfrytëzimi e ndihmës juridike sekondare falas për secilën çështje juridike që është me interes për kërkuarin, përveç për:

- ✓ Punë doganore dhe tatimore.
- ✓ Inicim të procedurës për shpifje dhe ofendim
- ✓ Kompensim të demit jo material, përveç në raste për viktimat e veprave penale, si dhe në rast të vdekjes apo invaliditet të rëndë,
- ✓ Kundërvajtje dhe procedura për kundërvajtje,
- ✓ Shërbimet publike dhe komunale të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit dhe Ligjin për veprimtari komunale
- ✓ Çështjet pronësore në procedurën administrative (denacionalizim, privatizim, legalizim etj).

KU TË DREJTOHEM?

Për sigurimin e ndihmës juridike falas, mund të drejtoheni:

A. Në një nga 34 njësitë rajonale në Ministrinë e drejtësisë, në pajtim me vendbanimin/vendqëndrimin tua.

Njësitë rajonale mund t'ju japin informacion të përgjithshëm juridik apo këshillë juridike, këshillë për shfrytëzimin e të drejtës të ndihmës juridike falas dhe t'ju ndihmojnë për përfundimin e kërkesës për ndihmë juridike sekondare.

Kontakti i drejtëpërdrejtë për njësitë rajonale: https://www.pravda.gov.mk/Upload/Editor_Upload//Mob-TEL-Na%20PodracniODD%201.pdf

B. Shoqatat dhe klinikat juridike (në kuadër të fakulteteve juridike) të cilat janë të regjistruara për dhënien e ndihmës juridike falas

Shoqatat dhe klinikat juridike, krahas informacionit të përgjithshëm dhe këshillës juridike, mund t'ju ndihmojnë edhe për përpilimin e formularëve të thjeshtë në proce-



durën administrative, për përpilimin e parashtresës deri te Avokati i popullit dhe Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, si dhe për përpilimin e kërkesës për mbrojtje të drejtave dhe lirive tuaja para Gjykatës kushtetuese.

Para se të vendosni për veprimin që do të ndërmerri, do ju shpjegohet natyra e problemit dhe do ju ndihmohet për të përcaktuar nëse problemi juaj është çështje juridike, nëse e njëjta është në kuadër të fushëveprimit të shërbimeve juridike të cilat mund të jepen, si dhe llojet e ndihmës juridike të cilat janë më përkatëse për ju.

Listën e shoqatave dhe klinikave juridike ku mund të drejtoheni për këshillë, mund ta gjeni në këtë link: <https://www.pravda.gov.mk/bpp>

C. Avokat me autorizime të fituara për dhënien e ndihmës juridike sekondare.

Avokatët me autorizimin e fituar për dhënien e ndihmës juridike sekondare, veprojnë në kuadër të këtij ligji vetëm në rast kur kërkuesit i është miratuar shfrytëzimi i

Ndihma juridike falas

ndihmës juridike sekondare me Vërtetim të lëshuar nga njësia rajonale apo me Aktvendim të Ministrisë të drejtësisë (kur ka vendosur pozitivisht pas kundërshtimit të dorëzuar). Në këtë rast, avokati është i detyruar që ndihmën juridike ta jap vetëm për punën juridike konkrete të shënuar në vërtetim. Avokati i caktuar nuk mund të refuzojë që të jap ndihmë juridike dytësore, përveç kur nuk është në pajtim me rregullat etike apo kufizimet e parapara me aktet e Dhomës të avokatëve. Shërbimet të cilat avokati i jep në kuadër të LNJK janë falas për shfrytëzuesit.

Lista e avokatëve të cilët kanë autorizime për dhënien e ndihmës sekondare është e disponueshme në: <https://www.pravda.gov.mk/bp-advokati>. Ju lutemi që të keni parasysh se avokati është i detyruar që të jap ndihmë juridike sekondare falas vetëm pasi që të jetë caktuar me aktvendim për lëndën tuaj nga ana e Ministrisë të drejtësisë.

A DUHET TË PAGUAJ DIÇKA?

Shërbimet e ndihmës juridike primare janë falas për të gjithë. Shërbimi i ndihmës juridike sekondare (shërbimi nga avokati, zhvillimi i procedurës gjyqësore), është falas pas marrjes të Aktvendimit për dhënien e ndihmës juridike falas, dhe përfshin këto shpenzime:

- ✓ Lirimi nga pagesa e ndihmës profesionale të avokatit për përfaqësimin dhe përpilimin e shkresave në procedurat e theksuara dhe procedurat para Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, Fondit për sigurim shëndetësor dhe personave të cilët ushtrojnë autorizime publike (noterë dhe përmbarues, nën kushte të veçanta)
- ✓ Lirimi nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore në lidhje me procedurën para gjykatës;
- ✓ Lirimi nga shpenzimet për ekspertizë, nëse është e nevojshme në procedurë, dhe
- ✓ Lirimi nga taksat administrative.

Ligji për ndihmë juridike falas nuk i mbulon vetëm shpenzimet e palës të paditur në rast të humbjes të kontestit.



KU MUND TË DREJTOHEM PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS?

- ✓ Shoqata dhe klinika juridike të cilat janë të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike falas
- ✓ Avokatë me kompetenca të fituara për dhënien e ndihmës juridike dytësore
- ✓ Në zyrat rajonale të Ministria e Drejtësisë (lista e kontakteve në shtojcë):

Njësitë rajonale	Telefonat
Berovë	071 205 324
Manastir	071 223 392
Makedonski Brod	071 223 075; 078 640 786
Vinicë	071 213 964
Vallandovë	071 213 925
Gjevgjeli	071 224 678; 071 216 267
Gostivar	071 223 180
Dibër	071 223 768
Delçevë	071 283 948
Demir Hisa	075 766 695
Kavadarë	075 659 855
Kërçovë	071 224 652
Koçanë	071 221 580
Kratovë	
Kriva Pallankë	071 224 580
Krushevë	071 227 808
Kumanovë	071 227 962

Njësitë rajonale	Telefonat
Negotinë	071 223 191
Ohër	071 221 908
Prilep	076 232 886
Probishtip	078 330 434
Radovish	070 261 310
Resnjë	071 221 246
Sveti Nikole	071 227 862
Strugë	071 223 015
Strumicë	071 224 526
Tetovë	071 227 893
Veles	
Shtip	071 221 484; 070 821 089
Karposh	071221381
Qendra	078 442 006
Kisella Vodë	071 224 104
Gazi Babë	071 213 798
Çairit	



INFORMOHU
PËR NDIHMËN
JURIDIKE FALAS

www.pravnapomos.mk

Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.
Qëndrimet e shprehura në të nuk shprehin domosdoshmërisht mendimin zyrtar të secilës palë.

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Drejtësisë